

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, bazuar në kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja, me nr.43-534/3, të dt.24.05.2018, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2018, mori këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.**
2. **Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.**


T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- Drejt. së ad.
- DFEZH
- MAPL-së
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri





Dalës-Izlasna

Nr. 1-94
Br.

Data 29.06.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria Vlada -Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**RREGULLORE (KO) NR.2 / 2018 PËR TARIFA,NGARKESA DHE
GJOBA KOMUNALE**

OBILIQ/ Qershor / 2018

Në bazë të nenit 12.2, nën pikën (c) dhe nenit 17 pika (s) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 03/2014, Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 2 paragrafi 3 dhe nenit 8, të Ligjit Nr-03/L-49, për Financat e Pushtetit Lokal, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr -27/2008), nenit 38.pika -1/3 nenit 83 pika 7, dhe nenit 89 të Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34 të datës 25.04.2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2018, miratoi:

RREGULLORE PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1. Qëllimi

Me këtë Rregullore caktohet lartësia e tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime nga veprimtarit komunale ,që duhet ti paguajnë, personat fizik dhe juridik në emër të: shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, apo sipas detyrës zyrtare.

Po ashtu me këtë Rregullore caktohen edhe tarifat për ushtrim të veprimtarisë afariste dhe tarifat për shërbime profesionale, inspektimet komunale nga ana e inspektorëve ,pronësisë së automjeteve motorike ,përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin apo rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrat nga qiradhënia, bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi, gjobat komunale, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.

Neni 2. Përcaktimi i tarifave

Lartësia e ngarkesave, tarifave dhe gjobave që do të paguajnë , personat fizik dhe juridik, nuk duhet ta tejkalojnë koston e ofrimit të shërbimit dhe përcaktohen me rregullore komunale në emër të shërbimit që ofrohet.

Neni 3. Inkasimi i të hyrave vetanake

Për inkasimin e të hyrave vetanake kujdeset secila drejtori, ndërsa Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim do ta bëjë përcjelljen e dinamikës së realizimit të të hyrave vetanake.

Neni 4.
Mënyra e pagesës së taksës administrative

1. Taksa administrative paguhet në shumën e caktuar me Rregullore. Paguesi është i obliguar të paraqes dëshminë adekuate që taksa është paguar.
2. Pagesa e taksës/tarifës është e detyrueshme prej momentit kur personi fizik apo juridik e paraqet kërkesën.
3. Pagesa bëhet në arkë me para të gatshme - për pagesat deri në € 10.00 (dhjetë).
4. Pagesat mbi €10.00 (dhjetë) e më lartë bëhen direkt në bankë, me një urdhër për pagesë në të cilin është dhënë numri i llogarisë për veprimet e rregullta të Komunës së Obiliqit.

Neni 5.
Pagesat në këste

Tarifat vjetore në biznes për subjekte afariste do të paguhet në dy (2) këste të barabarta, kësti i parë deri më 15 maj dhe kësti i dytë deri më 15 tetor të vitit.

Neni 6.
Përfshirimi (lirimi) nga pagesa

1. Përgjithësisht nga pagesa e taksës administrative lirohen:

- 1.1 . Organet lokale, regjionale, qeveritare të Republikës së Kosovës si dhe organet e tyre, të cilat adresojnë kërkesa zyrtare;
- 1.2. Institucionet publike në fushat e: fëmijëve parashkollorë, arsimit, shkencës, kulturës, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, shëndetit, mirëqenies sociale, për kërkesat/aktivitetet e tyre
- 1.3. Invalidët e luftës, veteranët, viktimat e dhunës seksuale të luftës si dhe, familja e ngushtë e dëshmorëve, viktimave civile dhe të zhdukurve të UÇK-së. (sipas Ligjit Nr. 04/L-172 dhe Ligjit Nr. 04/L-054);
- 1.4. Personat me aftësi të kufizuar (sipas Ligjit Nr.03/L-019);
- 1.5. Personat e verbër (sipas Ligjit Nr.04/L-092);
- 1.6. Rastet sociale.

2. Nga pagesa e taksës administrative gjithashtu lirohen:

- 2.1 Peticionet, ankesat dhe propozimet drejtuar qeverisë dhe organeve tjera publike;
- 2.2. Dokumentet dhe veprimet në procedurën e korigjimit të gabimeve të bëra nga zyrtarët përgjegjës komunal në vendime, dokumente dhe regjistra zyrtarë;
- 2.3. Dokumentet dhe shërbimet për të cilat lirimi i pagesës është rregulluar me rregulloret ose vendimet komunale të specifikuara për shërbime të caktuara;

2.4. Vërtetimi mbi pranimin e kërkesës apo lëndës;

3. Nëse procedura është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave, atëherë taksa administrative paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa.
4. Nëse vendimi apo dokumenti lëshohet pa pagesën e taksës administrative atëherë shkresa e bashkangjitur duhet të tregojë qëllimin e dhënies dhe bazën e përjashtimit nga pagesa. Në këtë rast duhen bashkangjitur dokumentet përkatëse (vërtetimi) të cilat e reflektojnë këtë procedure.

KAPITULLI II

Neni 7.

GJOBAT

Nëse obligimet e caktuara me vendim nuk paguhen brenda afatit të caktuar sipas nenit 5, do të pasojnë ndëshkimet sipas Ligjit për kundërvajtje :

1.Gjobat nga trafiku

Alokimi i mjeteve të arkëtuara bëhet sipas dispozitave të rregullores për thesarin. Mjetet e arkëtuara mund të jenë si rrjedhojë e arkëtimit të tyre nga dënimet mandatare, përmes PK-së dhe vendimeve përfundimtare të Gjykatës kompetente.

2. Gjobat për veprimtari afariste

Ndaj subjektit afrist i cili nuk bënë pagesën e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste të caktuar për vitin fiskal sipas afateve, do të inicohet procedurë gjyqësore në Gjykatën kompetente për ekzekutim të dhunshëm.

3.Gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale

Rregulloret lokale, të miratuara nga Kuvendi i komunës së Obiliqit , përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave nga bartësit konkretë. Lartësia e gjobës është e bazuar në proporcion me fajësinë e bërë nga shkelësi i dispozitave të rregulloreve komunale. Në rastet kur subjektet nuk i përgjigjen pagesës, së tarifave dhe ngarkesave komunale të parapara me këtë Rregullore, do të kërkohet ekzekutimi i dhunshëm përmes Gjykatës kompetente.

Neni 8.

Evidenca e pagesave

Drejtoritë përkatëse komunale për tarifatat, ngarkesat, gjobat dhe pagesa tjera sipas kësaj Rregullore, do të mbajnë evidencë në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 9.

Obligimet

Personat fizik apo juridik të cilët gjatë punëve ndërtimore kanë bërë dëmtimin e rrugëve apo hapësirat tjera publike obligohen të evitojnë dëmet e shkaktuara në afat prej 5(pesë)ditësh.

Neni 10.
Parashtrimi i kërkesave

Të gjitha subjektet ekonomike, shfrytëzuesit e hapësirave publike dhe personat tjerë, të cilët sipas dispozitave të kësaj Rregullore janë obligues të ngarkesave të parapara, obligohen që në afatin e paraparë të ushtrojnë kërkesat me shkrim në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

KAPITULLI III
ANKESAT DHE MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 11.
Ankesat

Personi mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga Komuna, nëse ai /ajo deklaron se i janë shkelur të drejtat e tij.

Procedura e ankesës duhet të jetë në pajtueshmëri me procedurën e referuar në nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe sipas Ligjit të procedurës së Përgjithshme Administrative.

LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Lartësinë e tarifave dhe ngarkesave që do të paguajnë personat fizik e juridik, në emër të shërbimeve të ofruara nga ana e administratës komunale apo veprimtarive komunale sipas drejtorive, në pajtim me këtë Rregullore, do të jenë, si në vijim:

KAPITULLI IV

Neni 12

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Taksat administrative vërtetimet dhe dokumentet zyrtare

1.	Spektori i përgjithshëm	Euro(€)
1.1	Për fotokopjimin dhe vërtetimin e identitetit nga arkivi.	3.00
1.2	Vërtetimi i deklaratës mbi raportin e lidhjes familjare	2.00
1.3	Vërtetimi i deklaratës që personi është i vetëm	2.00
1.4	Vërtetimi i deklaratës mbi vendqëndrimin e përkohshëm	5.00
1.5	Për huazimin e dokumenteve te lejueshme nga arkivi	5.00
1.6	Vërtetimi i deklaratës mbi nacionalitetin e qytetarit (kombësinë)	2.00
1.7	Vërtetimi i deklaratës mbi mbikëqyrjen e anëtarit te familjes	2.00
1.8	Vërtetimi i deklaratave të ngjashme varësisht nga kushtet aktuale	2.00
1.9	Vërtetimi i deklaratës mbi jetën e përbashkët deri në vdekjen e bashkëshortit.	1.00
1.10	Legalizimi I fotokopjes krahasuar me dokumentin origjinal (një faqe çdo faqe shtesë 0.50 € mbi pesë faqe lirohet nga pagesa)	1.00
1.11	Certifikatë të lindjes	1.00
1.12	Certifikatë të martesës	1.00
1.13	Certifikatë të vdekjes	1.00
1.14	Aktvdekje (trashëgimia)	5.00
1.15	Ceremoninë e lidhjes së martesës	10.00
1.16	Konfirmim te certifikatave, LAL, LAM e tjera	1.00
1.17	Regjistrimin e mëvonshëm të faktit te lindjes	10.00
2.	Spektori i ofiqarisë	
2.1	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes (deri në 5 vjet: 5.00€, kurse pas 5 viteve: 10.00€)	5.00
2.2	Ndërrimin e emrit personal (deri në moshën 18 vjeçare) (mbi moshën 18 vjeçare) (për pensionistet 50% zbritje këtu)	10.00
2.3	Korrigjimin e shënimeve në librat amë, Nëse ka qenë gabim i Komunës të jetë falas	5.00
2.4	Lidhje martesore jashtë orarit të punës	0.00
2.5	Lidhje martesore jashtë selisë (zyrave) të Komunës	40.00
2.6	Lidhje martesore, kur njeri bashkëshort është shtetas i huaj	70.00
2.7	Deklaratë te bashkësisë familjare (për përdorim ne Kosovë)	50.00
2.8	Deklaratë te bashkësisë familjare jashtë Kosovës	1.00
2.9	Regjistrimi në librat special të lindjeve, martesave (jashtë Kosovës)	5.00
2.10	Vërtetim të shtetësisë	5.00
2.11	Vërtetimi që personi është në jetë	2.00
2.12	Certifikatë të statusit të lirë martesor	3.00
2.13	Vërtetim të vendbanimit ose vërtetime tjera	3.00
2.14	Konfirmim për lëndën e martesës, me kërkesë të DRGJC	1.00
		3.00

2.15	Lidhje martesore me shtetas të huaj (jashtë orarit te punës)	70.00
2.16	Lidhje martesore me shtetas te huaj jashtë orarit dhe jashtë selisë së komunës -----	100.00
2.17	Kurorëzimet jashtë objektit të Administratës në vende publike	30.00

KAPITULLI V

Neni 13

DREJTORIA PËR EKONOMI FINANCA DHE ZHVILLIM

Tarifat sipas llojit të veprimtarisë afariste

1	Tarifat nga ushtrimi i veprimtarive afariste	Vlera në €
1.1	Nxjerrja dhe përpunimi i qymyrit	20.000.00 €
1.2	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike	15.000.00 €
1.3	Shpërndarja e energjisë elektrike	7.500.00€
1.4	Nxjerrja e gurit(gurthyesit)	2.000.00 €
1.5	Prodhimi i tullave,tjegullave etj.nga balta(të pjekura)	2.000.00 €
1.6	Punime të përgjithëshme mekanike	2.000.00 €
1.7	Prodhimi i gazit, shpërndarja e kanalizuar e lëndëve djegëse	2.000.00 €
1.8	Transporti i mallrave hekurudhor	1.000.00 €
1.9	Prodhimi i betonit të gatshëm për ndërtim	1.000.00 €
1.10	Prodhimi i produkteve nga druri (fabrikat)	800.00€
1.11	Prodhimi i produkteve nga plastika, folive. etj (fabrikat)	800.00€
1..12	Ndërmarrjet për përpunim të armaturave, prodhimin e dritareve ,portave metalike ,alumini ,plastike,e të ngjashme	1.000.00 €
1.13	Telekomunikimet (Posta-telefoni)	1 000.00 €
1.14	Ndërmjetsimet monetare (bankat)	1000.00 €
1.15	Kompanitë e sigurimeve	1000.00 €
1.16	Kompanitë tregtare "Import –Export" baza	1.000.00 €
1.17	Bastoret (Lojrat e fatit)	1.000.00 €
1.18	Kompanitë e mëdha ndërtimore –ndërtimi i lartë dhe i ulët	800.00 €
1.19	Kompanitë që merren me ndërtimtari dhe punë tjera ndërtimore	300.00 €
1.20	Tregtia me shumicë e mallrave të tjera ushqimore	500.00 €
1.21	Hipermarketet	400.00 €
1.22	Supermarketet	300.00 €
1.23	Minimarketet	200.00 €
1.24	Dyqanet tregtare (B.I.)	100.00€
1.25	Tregtia me shumicë me karborante dhe lubrifikante(deponitë)	1.000.00 €
1.26	Tregtia me pakicë me karborante dhe lubrifikante (në rrugët Magjistrale)	700.00 €
1.27	Tregtia me pakicë me karborante dhe lubrifikante (në rrugët rajonale)	500.00€
1.28	Tregtia me pakicë me karborante dhe lubrifikante (në rrugët rajonale periferi)	400.00€
1.29	Njësitë për shitjen e karburanteve dhe lubrifikanteve tarifa 30% Pika e shitjes së karburanteve.... Kafiteria Minimarketet.... Autolarja....	30 %
1.30	Tregtia e automjeteve motorike -(shitja e automjeteve) Për çdo njësi	400.00 €
1.31	Tregtia e automjeteve të vjetra motorike	200.00 €
1.32	Tregtia e pjesëve dhe mjeteve motorike	300.00 €

1..33	Tregtia me shumicë e mobileve	400.00 €
1.3 4	Tregtia me shumicë e drurit, materialit ndërtimor dhe pajisjet sanitare	300.00 €
1.35	Tregtia me shumicë e produkteve farmaceutike (Barnatoret humane)	200.00 €
1.36	Tregtia me shumicë e tekstilit	300.00 €
1.37	Tregtia me shumicë e pemëve dhe perimeve	300.00 €
1.38	Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit	300.00 €
1.39	Hotelet	600.00 €
1.40	Motelet	400.00 €
1.41	Restaurantet	200.00 €
1.42	Ndërmarrjet hoteliere (me restaurante,menza) baza	1.000.00 €
1.43	Fabrikimi i miellit (mullinjtë elektrik)	300.00 €
1.44	Ndërmarrjet e mesme prodhuese – të gjërave ushqimore	400.00 €
1.45	Institutet (hulumtimet shkencore –projektuese e të ngjashme)	1.000.00 €
1.46	Transporti tjetër tokësor i udhëtarëve (urban)	200.00 €
1.47	Veprimtaritë e agjencive të udhëtimit dhe turizmit	300.00 €
1.48	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finisimi	200.00 €
1.49	Rregullimi dhe montimi i taksimetrave të automjeteve	200.00 €
1.50	Kooperativat bujqësore sh.p.k.	200.00 €
1.51	Kompanitë e mbeturinave (deponitë regjionale të mbeturinave)	1.000.00 €
1.52	Kompanitë të cilat ushtrojnë veprimtari të llojeve të ndryshme me bazë qendrore në të njëjtin lokacion (të gjitha në një vend)	1.000.00 €
1.53	Auto- sallonet –tregtia e automjeteve	200.00 €
1.54	Kompanitë tjera të cilat nuk janë të përfshira	400.00 €
1.55	Pishinat e hapura	150.00 €
1.56	Pishinat e mbyllura me restaurante –Ushqim të përgaditur	300.00 €
1.57	Fushat sportive për rekreacion –Lojëra	100.00 €
1.58	Ndërmarrjet me shumicë të grumbullimit të metaleve (hekraritë)	300.00 €
1.59	Kompanitë e mëdha të instalimeve elektrike (tensioni i lartë)	1.000.00 €
1.60	Shtypshkronjat	300.00 €
1.61	Ndërmarrjet botuese	300.00 €
1.62	Prodhuesit dhe përdoruesit e produkteve ushqimore	300.00 €
1.63	Prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit dhe produkteve nga qumështi	200.00 €
1.64	Prodhimi i dyerve dhe dritareve nga plastika	300.00 €
1.65	Prodhimi i mobiljeve nga druri dhe llojet tjera të drurit (kuzhinat) etj ---	300.00 €
1.66	Prodhuesit tjerë (produkteve higjienike, sanitare etj)	300.00 €
2	Bizneset individuale B.I.	
2.1	Tregtia me pakicë e ushqimit pijeve dhe duhanit	100.00 €
2.2	Tregtia me pakicë e tekstilit	100.00 €
2.3	Tregtia me pakicë e veshjeve	100.00 €
2.4	Tregtia me pakicë e mobileve	150.00 €
2.5	Tregtia me pakicë e pemëve dhe perimeve	100.00 €
2.6	Tregtia me pakicë e aparateve elektrike	150.00 €
2.7	Barnatoret bujqësore	100.00 €
2.8	Veprimtarit e argjendarëve ,artarëve	100.00 €
2.9	Tregtia me pakicë e artikujve të sportit	100.00 €
2.10	Tregtia me pakicë e librave, fletoreve etj.	70.00 €
2.11	Tregtia me pakicë e artikujve të përzier deri në 1.30 €	100.00 €
2.12	Tregtia me pakicë e ngjyrave dhe llaqeve	100.00 €
2.13	Tregtia me pakicë e artikujve të imët metalik dhe materialit instalues	100.00 €
2.14	Tregtia me pakicë e tepihëve, perdeve, qebeve etj.	100.00 €
2.15	Tregtia me pakicë e artikujve kozmetik	70.00 €
2.16	Tregtia me pakicë e pjesëve të automjeteve	100.00 €
2.17	Tregtia me pakicë e mishit	100.00 €
2.18	Qebaporet	100.00 €

2.19	Gjellëtoret	100.00 €
2.20	Byrektoret	100.00 €
2.21	Kafe bar	100.00 €
2.22	Piceritë	100.00€
2.23	Tregtia me pakicë e luleve	70.00 €
2.24	Tregtia me pakicë e videokasetave CD	70.00 €
2.25	Tregtia me pakicë e artikujve të përdorur	100.00 €
2.26	Shitja në qoshqe (kioskë) deri në 6m ²	70.00 €
2.27	Shitja në stende, jashtë dyqaneve	50.00 €
2.28	Ndërmjetësime të tjera financiare,p.c	100.00 €
2.29	Njësitë e ekspoziturës(brenda kompanisë)	50.00 €
2.30	Tregtia me pakicë e produkteve tjera të cilat nuk janë të cekura më lartë	100.00 €
3	Bizneset individuale B.I.- zejtare	
3.1	Autoservis – Autolimar, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	100.00 €
3.2	Mirëmbajtja dhe riparimi i aparateve llogaritëse (kompjutereve)	70.00 €
3.3	Furrat e bukës	100.00 €
3.4	Gomisteret	100.00 €
3.5	Teneqepunuesit	100.00 €
3.6	Autolarjet	70.00 €
3.7	Metal gdhendësit	100.00 €
3.8	Fotografët	100.00 €
3.9	Fotokopjuesit	50.00 €
3.10	Orëtarët	50.00 €
3.11	Pastrimi kimik	70.00 €
3.12	Veprimtaritë që merren me pastrimin e objekteve	70.00 €
3.13	Serviset për riparimin e aparateve ,TV etj.	70.00 €
3.14	Serviset për amvisëri	70.00 €
3.15	Çelëspunues	50.00 €
3.16	Serviset e aparateve të zjarrëfikjes	70.00 €
3.17	Sallon ondulimi, zbukurimi	50.00 €
3.18	Frizer	50.00 €
3.19	Rrobaqepës, sallon i nusërisë	50.00 €
3.20	Autoparkingjet	100.00 €
3.21	Lojrat për argëtim të fëmijëve	100.00 €
3.22	Këpucëtalet, farkatalet	50.00 €
3.23	Miniferma	50.00 €
3.24	Serat	50.00 €
3.25	Auto taxi	50.00 €
3.26	Shitësit jashtë dyqaneve	70.00 €
3.27	Zdrukthëtalet –punime nga druri	100.00 €
3.28	Shitësit e luleve	70.00 €
3.29	Punuesit e vulave dhe vizit -kartave	70.00 €

4	Tarifa për leje dhe shërbime profesionale	
4.1	Tregtia me shumicë e karburanteve-deponitë	1.000.00 €
4.2	Tregtia me pakicë e karburanteve (rr.magjistrale)	700.00 €
4.3	Tregtia me pakicë e karburanteve (rr.rajonale)	500.00 €
4.4	Hotelet	700.00 €
4.5	Motelet	500.00 €
4.6	Bankat	1.000.00€
4.7	Kompanitë që merren me sigurimin e objekteve	1.000.00 €
4.8	Njësit e kompanive të sigurimit	300.00 €
4.9	Ordinancat shëndetësore	200.00 €

4.10	Veprimtaritë e praktikës stomatologjike	200.00 €
4.11	Laboratorët për analiza të ndryshme	100.00 €
4.12	Barnatoret – humane	200.00 €
4.13	Rëntgenit	200.00 €
4.14	Fizioterapeutët	200.00 €
4.15	Avokatët	200.00 €
4.16	Noterët	300.00 €
4.17	Kontrollimi teknik i automjeteve	400.00 €
4.18	Testimi teknik dhe analiza deri ne 3.5 t	200.00€
4.19	Kontabilistët	100.00 €
4.20	Veprimtaritë e shkollave për shofer	100.00 €
4.21	Arsimi parashkollorë dhe fillor	100.00 €
4.22	OJQ- të me karakter profiti (fitimi)	150.00€
4.23	Ndërmarrjet ndërtimore (punët në ndërtimtari)	300.00 €
4.24	Ndërmarrjet ndërtimore me punë përfundimtare në ndërtimtari	200.00 €
4.25	Ndërmarrjet projektuese(profesionale-institute)	1.000.00 €
4.26	Ndërmarrjet e vogla të cilat merren me punë profesionale Gjeodetët,Arkitektët,Ndërtimtarët etj.	200.00 €

5. Subjektet –bizneset që në komunën e Obiliqit kane njësi ,si ato që bazën e kanë diku tjetër si ato që bazën e kanë në komunën e Obiliqit paguajnë 30% për njësi.

6. Bizneset me orar të shkurtuar paguajnë 50 % të tarifës vjetore.

8. Bizneset të cilat nuk punojnë janë të liruara nga tarifa por për këtë paraprakisht të sjellin dëshmi për lirim nga ngarkesa, pasqyrën prej ATK-së për të dëshmuar se subjekti i tyre nuk ka zhvilluar kurrfarë aktiviteti për të cilën janë regjistruar, por nëse haset gjatë vizitave në terren se biznesi është duke punuar atëherë automatikisht ngarkohet në mënyrë retroaktive.

Neni 14 Lehtësirat në biznes

1. Në këtë pako stimuluese hyn: Mikro-bizneset , bizneset e vogla dhe të mesme të cilat kanë të punësuar nga 5 deri 50 punëtores.
2. Nga pagesa e tarifave në biznes ,bizneset e vogla dhe të mesme me veprimtari prodhuese për dy(2) vitet e para ,prej ditës së themelimit të ndërmarrjes ,si dhe 50% pas dy (2) viteve të punës të biznesit deri në vitin e tretë ,më kusht që aktiviteti mos të shkëputet më së paku tri vitet në vijim.
3. Bizneset të cilat janë nën investime (zgjerim të prodhimit) të lirohet nga tarifat në biznes përderisa të filloj aktiviteti afaristë.
4. Bizneset të cilat kanë të punësuar qytetar të komunës së Obiliqit prej (5-10) në tarifë të biznesit për 20 %.
5. Bizneset të cilat kanë të punësuar qytetar të komunës së Obiliqit prej (11-30) në tarifë të biznesit për 30%
6. Bizneset të cilat kanë të punësuar qytetar të komunës së Obiliqit prej (31-50) në tarifë të biznesit për 40%.
7. Bizneset fillestare në vitin e parë nga tarifa vjetore në biznes bazuar në datën e regjistrimit marrjes së Certifikatës .

Neni 15

Tarifat dhe ngarkesat mbi kriterin dhe lartësinë për ndertimin dhe rindërtimin e ndërtesave

1. Aplikacionet për leje ndërtimore ,përdorimi ,legalizimi dhe caktimi i kushteve urbanistiko-teknike do të paguhen në taksa sipas vlerave siç janë paraqitur më poshtë :

1.1.	Pëlqimi Urbanistik	tarifa	15.00 €
1.2.	Paraqitja e kërkesës për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike	tarifa	10.00 €
1.3.	Për paraqitjen e kërkesave për leje ndërtimore	tarifa	10.00 €
1.4.	Për paraqitjen e kërkesave për legalizim	tarifa	100.00 €
1.5.	Për paraqitjen e kërkesës për vlersime të ndryshme	tarifa	10.00 €
1.6.	Për paraqitjen e kërkesës për dhënien e Referencave	tarifa	10.00€
1.7.	Për paraqitjen e kërkesës për Leje përdorimi	tarifa	10.00€

Sqarim:

Këto tarifa janë bazuar në Ligjin Për Ndërtim Nr:04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ me nr:22/2012 për lëshimin e Lejes Ndërtimore dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës .

2. Taksa Administrative për lëshimin e Lejes së ndërtimit e llogaritur nga Komuna e Obiliqit është 1.91 € /m² (një euro e nëntëdhjete e një cent për metër katror).

Neni 16

1. Të hyrat nga qiradhënia në shfrytëzim të përkohshëm të tokës

- 1.1. Toka me shfrytëzim të përkohshëm pa ndërtime plotësuese për kultivimin e kulturave bujqësore caktohet tarifa vjetore100.00 € /ha
- 1.2. Qiraja për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm për ngritjen e objektit për qëllim afarizmi tarifa mujore1.00 € / m²
- 1.3. Tokat me shfrytëzim të përkohshëm me ndërtime të objekteve për qëllim të bizneseve komerciale caktohet tarifa :

a)	Zona e I –rë	Tarifa vjetore	0.05 € m ²
b)	Zona e II –të	Tarifa vjetore	0.04 € m ²
c)	Zona e III –të	Tarifa vjetore	0.03 € m ²
d)	Zona e IV- të	Tarifa vjetore	0.02 € m ²

2. Ngarkesat nga Prona për Shfrytëzim afatshkurtër -

2.1	Objektet (zyra) në pronë komunale tarifa mujore-zona e I-rë4.00 € m ²
2.2	Objektet (zyra) në pronë komunale tarifa mujore-zona e II-të ,III-të ,IV-të2.00 €

	m ²	
2.3	Lokalet (afariste) në pronë të komunës tarifa mujore –zona e I-rë	4.00 € / m ²
2.4	Lokalet në pronë të komunës tarifa mujore –zona e II-të,III-të,IV-të	2.00 € / m ²
2.5	Dhënia në shfrytëzimi të banesave në pronë komunale tarifa mujore.....	0.10 € / m ²

3. Ngarkesa për Shfrytëzimin e Sipërfaqeve Publike ,detyrimi bazë është shfrytëzimi në m²,sipas zonave

3.1 Vendosja e qoshqeve (kiosqeve) dhe objekteve të tjera prej montazhi, në të cilat kryhet veprimtaria (tregti ,hoteleri), tarifa mujore sipas zonave :

a) Zona e I-rë .	tarifa	4.00 € / m ²
b) Zona e II-të .	tarifa	3.00 € / m ²
c) Zona e III-të	tarifa	2.00 € / m ²
d) Zona e IV-të .	tarifa	2.00 € / m ²

3.2 Vendosja e pajisjeve për akullore dhe pajisjeve të ngjashme tarifa mujore për m² sipas zonave:

a) Zona e I-rë	tarifa	4.00 €
b) Zona e II-të	tarifa	3.00 €
c) Zona e III-të	tarifa	2.00 €
d) Zona e IV-të	tarifa	2.00 €

3.3 Vendosja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollor, caktohet tarifa mujore për m² sipas zonave :

a) Zona e I-rë .	tarifa	4.00 €
b) Zona e II-të	tarifa	3.00 €
c) Zona e III-të	tarifa	2.00 €
d) Zona e IV-të	tarifa	2.00 €

3.4 Shfrytëzimi i hapësirës para objektit, në të cilën kryhet veprimtaria tregtare tarifa mujore sipas zonave

a) Zona e I-rë	tarifa	2.00 € / m ²
b) Zona e II-të	tarifa	1.00 € / m ²
c) Zona e III-të	tarifa	0.50 € / m ²
d) Zona e IV-të	tarifa	0.25 € / m ²

3.5 Shfrytëzimi i hapësirës para objektit në të cilën kryhen shërbime hoteliere tarifa vjetore sipas zonave :

a) Zona e I-rë	tarifa	5.00 € / m ²
b) Zona e II-të	tarifa	4.00 € / m ²
c) Zona e III-të	tarifa	3.00 € / m ²
d) Zona e IV-të	tarifa	2.00 € / m ²

3.6 Për shfrytëzime të veçanta të hapësirës publike, ekspozimi i mallit, ambalazhi caktohet tarifa vjetore sipas zonave:

a) Zona e I-rë	tarifa	10.00 € / m ²
b) Zona e II-të	tarifa	8.00 € / m ²
c) Zona e III-të	tarifa	5.00 € / m ²
d) Zona e IV-të	tarifa	3.00 € / m ²

3.7 Qiraja vjetore për garazha sipas standardeve e vendosur në pronë komunale tarifa vjetore120.00 €

3.8 Leja për vendosjen e transmetuesëve (antenave) me frekuenca të ndryshme për nevoja të telefonis mobile, fiks, TV, etj të ngjashme, tarifa paguhet sipas zonave (vlera e llogaritur e objektit)

a) Zona e I-rë tarifë vjetore për m ²	2,0%
b) Zona e II-të tarifë vjetore për m ²	1,5 %
c) Zona e III-të tarifë vjetore për m ²	1,0 %
d) Zona e IV-të tarifë vjetore për m ²	0,5 %

4. Ekspozimi publik i vitrinave reklamuese, vendosja e vitrinave për ekspozimin e malli jashtë lokalit në vende të frekuentuara (qytet) në pronë komunale caktohet tarifa mujore sipas zonave:

4.1 Zona e I-rë	tarifa	8.0 / m ²
4.2 Zona e II-të	tarifa	6.0 / m ²
4.3 Zona e III-të	tarifa	4.0 / m ²
4.4 Zona e IV-t	tarifa	2.00 € / m ²

5. Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve në qytet dhe jashtë qytetit

5.1 Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve në qytet

a) Tarifa vjetore –pronë Komunale.....	20.00 € m ²
b) Tarifa vjetore –pronë private.....	10.00 € m ²
c) Panotë reklamuese me ndricim paguhen me tarifë të shtuar për 20 % , ndërsa reklamimet e pijeve alkoolike dhe duhanit janë të ndaluara .	

5.2 Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve jashtë qytetit

a) Tarifa vjetore – pronë komunale.....	10.00 € m ²
b) Tarifa vjetore –pronë private	5.00 € m ²
c) Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak se 30 ditë, shtohet vlera për 30 %.	

6. Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lodrave argëtuese automatike të ndryshme, si dhe rekuizitave të tjera sportive

1. Për mbajtjen e aparateve për lojëra fati që sjellin fitim në para tarifa mujore për m ²	5 .00 €
2. Për mbajtjen e aparateve për lojëra argëtuese etj .tarifa mujore për m ²	5 .00 €
3. Për tavolinë të bilardos tarifa mujore për m ²	10 .00 €
4. Ngarkesa nga toka për shfrytëzim afat shkurtër kampingje,lojra etj tarifa ditore.....	0.10 € m ²

Neni 17

Inkasimit të rentës minerale nga institucioni përkatës

Mjetet financiare të dedikuara për zonën e veçantë sigurohen prej :

- 1.1 Inkasimit të rentës minerale nga institucioni përkatës ,njëzet përqind (20%) e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës ku ndodhet njësia biznese. (LIGJI NR.05/L-044 Për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij)

1.2 Ngarkesat për shfrytëzimin e burimeve natyrore

1.1 Renta minerale Qymyri (Linjiti) për ton	3.00 €
1.2. Renta minerale Argjilë për tulla për ton	0.13€
1.3. Renta për minerale të pa lidhura dhe inerte për(Rërë dhe zhavorr) në m ³	1.25€

Neni 18.

Taksa për Automjetet Motorike

1.	Për një automjet që peshon nën 3.5 tonë	10.00 €
2.	Për një automjet që peshon në 3.5 ton dhe mbi 3.5 tonë	20.00 €

3. Nga pagesa janë të liruar automjetet :Mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, (QKMF) Organizatave humanitare, Organeve shtetërore dhe organizatat publike komunale. Gjithashtu nga pagesat janë të liruar me paraqitjen e dëshmimeve përkatëse vetëm për një auto veturë ,Familjet e Dëshmorëve ,Invalidët e UÇK-së ,Veteranët e UÇK-së ,ish të Burgosurit Politik dhe Invalidët e punës.

KAPITULLI I VII

Neni 19. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

1. Lëshuarja e Certifikatave ,Vlerësimi ,Pëlqimet dhe Vërtetimet

1.1	Lëshimi i certifikatës për shitjen e prodhimeve bujqësore jashtë vendit	5.00 €
1.2.	Dalja e komisionit për vlerësimin e dëmeve, në bujqësi, blegtori, pylltari hidroekonomi...	5.00 €
1.3.	Lëshimi i certifikatës për prerjen e drunjve për ngrohje për m ³	2.00 €
1.4.	Lëshimi e certifikatës që merret me veprimtari bujqësore.....	1.00 €
1.5.	Fletëpagesa për damkosje të drunjve në pyje private me V=7m ³	1.50 €/m ³
1.6.	Fletëpagesa për damkosje të drunjve në pyjet private me V=mbi 7m ³	2.00 €/m ³
1.7.	Fletëpagesa për pyjet publike ,dru te thata,holla D=7cm.....	11.00 € m ³
1.8.	Fletëpagesa për pyjet publike ,dru te thata ,trasha mbi D=7cm.....	15.00 €m ³
1.9.	Për punët e komisionit në vlerësimin e dëmit pyllit ,pemishteve ,kulturave lavërtarë ,bagëtisë dhe pasurive tjera	10.00 €

2. Lëshimi i certifikatave për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore :

2.1.	Për klasën e IV-VI për m ²	1.00 €
2.2.	Për klasën e VII - VIII për m ²	0.75 €
2.3.	Për ndërrim të përkohshëm të destinimit për m ²	0.20 %

3. Tarifat për lëshimin e certifikatave ,pëlqimeve vërtetimeve

3.1.	Lëshimi i certifikatave për shitjen e produkteve blegtorale dhe lëkura.....	10.00 €
3.2 .	Pëlqimet për thyerjen e gurit dhënie e formës tarifa(vjetor).....	100.00 €
3.3.	Pëlqim për vendosjen e veglave për separim të zhavorrit.....	100.00 €
3.4 .	Pëlqim për prodhim të elementeve prej betoni	100.00 €
3.5.	Pëlqimi(vërtetimi)për gjueti dhe peshkim(për person)- tarifë në përtritje vjetore	5.00 €
3.6.	Vërtetim për të dëshmuar pronësinë e mekanizmit bujqësorë	3.00 €
3.7.	Vërtetim se një subjekt fizik merret me aktivitete bujqësore.....	3.00 €
3.8.	Vërtetim për shitjen e prodhimeve bujqësore në treg për vit.....	15.00 €
3.9.	Vërtetimet tjera që nuk janë të cekura më lartë.....	2.00 €

4 Inspektimet e veterinës

4.1. Inspektimi veterinar për kafshë të trasha, si p.sh. lopët, kuajt etj. tarifa	5.00 €
4.2 .Inspektimi veterinar për kafshë të imta, si p.sh. delet, dhitë, qentë, macet etj.....	1.00€
4.3 .Vërtetim i lëshuar për kafshë të imëta nga stacioni i veterinars.....	1.00€

KAPITULLI I VIII
Neni 20.
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

1. Tarifatat-taksat për pëlqime ,leje,dëmtim të infrastrukturës ,ndotje etj

1.1 Ndërhyrja pa leje në infrastrukturën publike	
a) Personi fizik	400.00 €
b) Personi juridik.....	800.00 €
1.2 Leja për kryerjen e punimeve në rrugë dhe trotuarë	
a) Për 1m ² dëmtim të asfaltit	50.00 €
b) Për 1m ² dëmtim të gurëve(bubëza ose pllaka).....	30.00 €
c) Për dëmtim të trotuarit (hapja e kanaleve në trotuar) gjatë ditës.....	50.00 €
d) Dëmtim i skajoreve në m gjatësi.....	30.00 €
e) Dëmtimi i rrigollave në m gjatësi.....	30.00 €
f) Personat fizik apo juridik të cilët gjatë punëve ndërtimore dëmtojnë rrugët hapësirat-objektet tjera publike, janë të obliguara t'i evitojnë dëmet e shkaktuara në afat prej 5 ditësh ,njëkohësisht duhet të bëjnë kërkesën pranë Komunës, dhe të marrin pëlqim ,në të kundërtën gjobiten me shumën e cekur më lartë.	
1.3 Procesi mbi plotësimin e kushteve teknike për auto-taxi, kamionët ,autobusët ,minibuset dhe mjete të tjera .	
a) Auto- vetura për pesë (5) ulëse	5.00 €
b) Për kamionët e lehtë deri 3.5 t,traktorë.....	15.00 €
c) Për kamion ,autobus ,minibus dhe mjete tjera të rënda	20.00 €
1.4 leja për vendosjen e rrjetit kabllor ,ormanëve shpërndarës dhe foltoreve telefonike	
a) Leja për vendosjen e rrjetit kabllor ajror dhe leja për ndërtimin e infrastrukturës nëntokësor (vendosja e rrjetit kabllor) taksat administrative ne vlerë	50.00 €
b) Vendosja e ormanëve shpërndarës MDF, Pës MDF, për copë-tarifë vjetore	30.00 €
c) Vendosja e foltorëve telefonike tarifa vjetore	30.00 €
1.5 Leja për vendosjen afatshkurtër në hapësirat publike	
a) Leje për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësira publike për 24 orë.....	20.00 €
b) Leje për ndalje auto veturave Pikap (ngarkim shkarkim)për mallra në trotuar tarifa mujore	5.00 €
c) Leje për ndalje Kombi Furgon (ngarkim shkarkim)për mallra në trotuar tarifa mujore	10.00 €
d) Leje për ndalje me kamion(ngarkim shkarkim)për mallra në trotuar tarifa mujore	20.00 €
1.6 Shfrytëzimi pa leje i trotuareve dhe hapësirave tjera publike	
a) Personi fizik.....	50.00 €
b) Personi juridik	100.00 €

1.7 Gërvishtja, prerja ,lakimi, ndotja ose dëmtimi në çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë: ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit etj.	
a) Dëmtimi i shtyllës ndriçuese(komplet).....	600.00 €
b) Dëmtimi i shenjave të trafikut –komplet	80.00 €
1.8 Lejet për ndërhyrje në infrastrukturë dhe hapësirë tjetër publike	
a) Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuar për m ²	50.00 €
b) Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara,parqeve etj.për m ²	25.00 €
c) Licencë për ushtrim të veprimtarisë së transportit rrugorë të udhëtarëve	300.00 €
d) Certificate autobusi (për çdo autobus të operatorit)	50.00 €
e) Aplikimi për Licencë për ushtrim të veprimtarisë transport i udhëtarëve	50.00 €

KAPITULLI I IX

Neni 21 DREJTORIA PËR ARSIM

1. Tarifat për arsim dhe qëndrim në çerdhe

1.1 Tarifa mujore për qëndrim në çerdhe	
a) Tarifa për fëmijun e parë	40.00 €
b) Tarifa për fëmijun e dytë	28.00 €
c) Tarifa për fëmijun e tretë	20.00 €
1.2 Duplikati i dëftesave ,diplomave në arsim	
a) Duplikati i diplomave	1.00 €
b) Duplikati i dëftesave	1.00 €
c) Vërtetime të ndryshme	1.00 €
